



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Njoftim për ndarje të subvencioneve për individë fizikë

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Neni 5 dhe Neni 8, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 04/197 (të datës 29 mars 2024) për zbatimin e Masës 1.7 - Skema e Granteve për Zanate të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, njofton të gjitha të interesuarat se nëpërmjet Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGj), në mbështetje me Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur, do të ndajë subvencione për individë fizikë me qëllim të fuqizimit dhe pavarësimit ekonomik të grave dhe vajzave.

Të drejtë aplikimi kanë personat fizikë, gra apo vajza që gëzojnë pension për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë, apo një (1) anëtare (grua/vajzë) nga familja e ngushtë (sipas Ligjit për familjen) e personave që gëzojnë pension për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë (të vërtetohet me anë të dokumentacionit përkatës):

- të cilat ndërmarrin nisma vetëpunësimi prej të cilave punësohen dhe sigurojnë mirëqënien familjare dhe/apo të të ardhurave për përmbushjen e nevojave bazike.

Kriteret e pranimit

Në mënyrë që propozimi për përfitim të mbështetjes financiare për startim të biznesit të jetë i pranueshëm, duhet të trajtojë një apo më shumë nga fushat e mëposhtme:

- Të ndikojë në fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave të cilat janë duke zhvilluar aktivitete në fushën e: bujqësisë, blegtorisë, bletarisë, shpezëtarisë, agrikulturës, artizanateve, trashëgimisë kulturore etj. përmes blerjes së:
 - pajisjeve,
 - pemëve drufrutore ose manore; apo
 - bagëtisë, shpezëve, apo bletëve;të cilat mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve të lartpërmendura.
- Të promovojë zhvillimin e turizmit rural nën drejtimin e grave/vajzave, duke investuar në përmirësimin e qasjes dhe shërbimeve për turistë.

Propozimi duhet të përmbajë:

- Përshkrim të detajuar të aktiviteteve të parapara dhe buxhetin e planifikuar, personat e angazhuar, mekanizmat e zbatimit, monitorimin, vlerësimin e ndikimit të masave të zbatuara, si dhe të jetë transparent;
- Plan të realizimit të aktiviteteve (Plani dinamik); si dhe
- Planin e detajuar të buxhetit.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 2000 (dy mijë) euro, ndërsa **shuma maksimale** për një projekt individual është 4000 (katër mijë) euro.

Thirrja për subvencione shpallet në ueb faqen e Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit <https://abgj.rks-gov.net/>.

Procedurat e pagesës

Procedurat e pagesës do të jenë pjesë e kontratës së nënshkruar në mes Autoritetit Kontraktues (ABGj) dhe përfitueses.

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga ABGj, dhe afatet e monitorimit, do të parashihen me kushtet e kontratës.

Dokumentacioni i nevojshëm

Aplikuesja, duhet të sigurojë dokumentet bashkë me projekt-propozimin, si në vijim:

1. Formulari i aplikimit(<https://abgj.rks-gov.net/publikimet/108/shpalljet-dhe-njoftimet>)
2. Kopjen e letërnjoftimit;
3. Dëshminë që gëzon pension për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë, apo që është anëtare (grua/vajzë) nga familja e ngushtë (sipas Ligjit për familjen) e personave që gëzojnë pension për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë;
4. Konfirmimin bankar;
5. Certifikatën e Gjykatës që nuk është nën hetime; si dhe
6. Vërtetimin tatimor.

Kriteret e aplikimit

Aplikueset duhet t'i dorëzojnë formularët e plotësuar për aplikim në formë elektronike ne këto adresa Adelina.I.Kajtazi@rks-gov.net, Refiqe.Murtezi@rks-gov.net dhe Albana.Lumi@rks-gov.net. Aplikimi konsiderohet i dorëzuar vetëm kur pranoni konfirmim me e-mail nga Adelina.I.Kajtazi@rks-gov.net, Refiqe.Murtezi@rks-gov.net dhe Albana.Lumi@rks-gov.net.

Formulari duhet të jetë i nënshkruar dhe i skanuar, duke ia bashkëngjitur të gjitha dokumentet e kërkuara të skanuara.

Ose ne kopje fizike çdo dite pune nga ora 13.30 deri me 15.30 ne zyrat e Agjencisë për Barazi Gjinore Ndërtesa e Qeveris ,Sheshi “Nene Tereza” kati i 7 , Zyra 711.

Afati për aplikim zgjatet prej 25/04/2024 deri 10/05/2024 .

Aplikacionet e dorëzuara pas mbylljes së afatit nuk do të merren parasysht.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularin e paraparë, i cili është i bashkëngjitur me thirrjen.

Projektet për subvencionim do të përzgjedhen nga komisioni i formuar nga Agjencia për Barazi Gjinore.

Data e nënshkrimit të marrëveshjes pas përzgjedhjes, për të gjitha përfitueset, do të shpallet në ueb faqe të ABGj-së.

Për informacione shtesë:

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: Shpresa.Zariqi@rks-gov.net

Personi kontaktues: Shpresa Zariqi

Adresa Elektronike: Shpresa.Zariqi@rks-gov.net

Tel: 038 200 14 276